



MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NDËRMJET
AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
DHE
URDHRIT TË STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË



HYRJE

Agjencia Kombëtare e Diasporës (AKD) dhe Urdhri i Stomatologut (USSH) (në vijim referuar individualisht si "Palë"), në vlerësim të dëshirës për realizimin e qëllimeve të përbashkëta;

Duke vlerësuar rëndësinë e përmirësimit të pozitës së pjesëtarëve të diasporës dhe mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të tyre, nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve dy palëshe;

Për të nxitur rrjetëzimin e profesionistëve shqiptarë, në fushën e stomatologjisë në diasporë;

Në zbatim të Ligjit nr. 16/2018 "Për diasporën" i ndryshuar, Ligjit Nr.115/2017 "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", Ligjit Nr.127/2014 "Për Urdhrin e Stomatologut në Republikën e Shqipërisë";

Duke patur parasysh se, Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për detyrë të bashkëpunojë dhe koordinojë aktivitetet me institucionet shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat brenda dhe jashtë vendit, për përmirësimin e pozitës së diasporës në botë;

Duke patur parasysh që, Urdhri i Stomatologut gjatë kryerjes së detyrave, mban lidhje të vazhdueshme me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë e institucionet në varësi të saj dhe me ministritë, institucionet qendrore dhe organizma të tjerë, të krijuar sipas legjislacionit në fuqi, publikë ose jopublikë;

Palët duke shprehur vullnetin për të bashkëpunuar dhe kontribuar në realizimin e qëllimit të këtij Memorandumi, kanë rënë dakord si më poshtë:



Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij Memorandumi është nxitja e bashkëpunimit midis Palëve për promovimin dhe koordinimin e lidhjeve me profesionistët shqiptarë në fushën e stomatologjisë në Shqipëri dhe shtetet pritëse në diasporën shqiptare.
2. Memorandumi synon nxitjen e koordinimit të veprimtarive të përbashkëta dhe ofrimit të kontributit në vendlindje të stomatologëve të cilët ushtrojnë profesionin në diasporë, me qëllim rritjen e standarteve profesionale.
3. Nxitjen e politikave të "turizmit dentar" në Shqipëri për anëtarët e komuniteteve shqiptare në diasporë me qëllim nxitjen e forcimit të lidhjeve me vendlindjen dhe politikatat e turizmit në Shqipëri;

Neni 2

Objekti

1. Objekti është pjesë integrale dhe thelbësore e Memorandumit në tërësi.
2. Npërmjet këtij Memorandumi palët synojnë të vendosin dhe forcojnë urat e bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve stomatologë dhe ndihmës stomatologë, të cilët veprojnë në diasporë dhe në Shqipëri, nëpërmjet organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe veprimtarive shkencore.
3. Dispozitat e këtij Memorandumi, do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3

Parimet e përgjithshme të bashkëpunimit

1. Brenda mandatit të tyre dhe në varësi të burimeve në dispozicion, Palët, në bashkëpunim, do të kenë konsultime për çështjet me interes të përbashkët. Palët do të shqyrtojnë kuadrin e duhur për këto konsultime kurdo që të jetë e nevojshme.



2. Palët do të mbështesin dhe zhvillojnë bashkëpunimin, mbi parimet e barazisë dhe përfitimit reciprok.
3. Palët bien dakord që aktivitetet do të koordinohen, në masën e mundshme, në një përpjekje për të arritur bashkëpunimin dhe kur interesat e përbashkëta e diktojnë, njëra Palë mund të kërkojë bashkëpunimin e Palës tjetër.
4. Secila Palë do të përpiqet, në përputhje me instrumentet përbërëse dhe vendimet e organeve kompetente, t'i përgjigjet në mënyrë të favorshme kërkesave të tilla për bashkëpunim, sipas procedurave të dakortësuara.

Neni 4

Fusha e bashkëpunimit

Pa paragjykuar bashkëpunimin në fusha të tjera, brenda mandateve të tyre përkatëse dhe në varësi të disponueshmërisë së burimeve, Palët bien dakord;

1. Të përkrahin dhe nxisin rrjetëzimin e profesionistëve shqiptarë në fushën e stomatologjisë në diasporë;
2. Të bashkëpunojnë në përgatitjen dhe evidentimin e stomatologëve /ndihmës-stomatologë shqiptarë, brenda dhe jashtë vendit.
3. Krijimin dhe përditësimin e bazës së të dhënave mbi stomatologët shqiptarë, që ushtrojnë profesionin e tyre jashtë vendit;
4. Në realizimin nga Urdhëri i Stomatologut i një "App" të përdorimit nga telefonat celularë, për komunikimin e lehtësuar të të interesuarve;
5. Të angazhohen në hartimin e nismave dhe projekteve të përbashkëta;
6. Në organizimin e konferencave apo veprimtarive shkencore në zbatim të këtij Memorandumi, në fushën e stomatologjisë brenda dhe jashtë vendit;
7. Në bashkëpunimin për publikime dhe botime të përbashkëta të paraqitura ose jo, në veprimtaritë shkencore të realizuara nga palët.
8. Në promovimin e stomatologëve në Shqipëri dhe jashtë saj për ofrimin e shërbimeve ndaj komuniteteve shqiptare në diasporë;



9. Të zhvillojnë bashkërisht një aktivitet vjetor, me qëllim promovimin dhe ndervëprimin ndërmjet stomatologëve në diasporë dhe në vendin e origjinës.

Neni 5

Konfidencialiteti

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përmbahet nga Palët në lidhje me këtë Memorandum, duhet të trajtohet si konfidencial.
2. Palët duhet të respektojnë parimet e mbrojtjes së të dhënave personale në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Memorandumi.
3. Pala nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe/ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta, pa marrëveshje paraprake me Palën dhe/ose Donatorin përkatës.

Neni 6

Realizimi i ndryshimeve

1. Memorandumi mund të ndryshohet apo rinovohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Ndryshimi i propozuar duhet të bëhet me shkrim nga njëra Palë dhe do të hyjë në fuqi, pas pranimit të saj me shkrim nga Pala tjetër.
2. Palët mund të aplikojnë për lidhjen e marrëveshjeve të veçanta shtesë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të vullnetit të palëve.

Neni 7

Zgjidhja e konflikteve

Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo kërkesë që rrjedh nga, ose në lidhje me këtë Memorandum, apo shkelja, ndërprerja ose pavlefshmëria e saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit ndërmjet Palëve.

Neni 8

Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja



1. Memorandumi hyn në fuqi, në ditën e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve, dhe publikohet në faqet zyrtare të Palëve.
2. Memorandumi lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
3. Memorandumi nënshkruhet në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku secilës i vihet në dispozicion një kopje autentike.

Nënshkruar në Tiranë, sot me datë 05.03.2021.

**URDHRI I
STOMATOLOGUT TË SHQIPËRISË
PRESIDENT
NIKOLL DEDA**

**AGJENCIA
KOMBËTARE E DIASPORËS
DREJTOR EKZEKUTIV
SONILA HYSI**